



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, konform dokumenteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, planit të punës dhe dokumenteve të veta strategjike, e ka përmbyllur suksesshëm vitin 2012.

### **Krijimi dhe përmirësimi i kornizës ligjore nga fusha e punësimit dhe e politikave sociale**

Në fushën legjislative kjo ministri gjatë këtij viti ka hartuar katër projektligje që janë miratuar në Kuvendin e Kosovës (Ligji Nr. 04/L-081, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-17 për shërbimet sociale dhe familjare (është miratuar në Kuvend në muajin mars 2012); Ligji Nr. 04L-83-për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve (është miratuar në Kuvend në muajin prill 2012); Ligji Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë (është miratuar në Kuvend në muajin maj 2012); Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-200 për greva (është miratuar në Kuvend në muajin shtator 2012).

Përveç ligjeve të miratuara në Kuvend në kuadër të MPMS-së, në pajtim me Programin Legjislativ të vitit 2012, janë hartuar dhe proceduar për shqyrtim në Qeverinë e Kosovës edhe këto projektligje:

Projektligji për skemat pensionale të financuara nga shteti (është miratuar në leximin e parë nga Kuvendi); Projektligji për siguri dhe shëndet në punë (është miratuar në leximin e parë nga Kuvendi); Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-136, për dhënien e lejeve për punë dhe punësim të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Përveç ligjeve të miratuara në kuvend dhe atyre të hartuara dhe të proceduara për shqyrtim në Qeverinë e Kosovës, për zbatimin e ligjeve nga fushëveprimi i MPMS-së, gjatë vitit 2012, janë nxjerrë edhe pesëmbëdhjetë (15) akte nënligjore.

### **Rritja e shkallës së punësimit dhe forcimi i trajnimeve profesionale sipas kërkesës së tregut të punës**



Çështja e uljes së shkallës së papunësisë është një ndër sfidat kryesore me të cilën në vazhdimësi përballet MPMS-ja. Po qe se e vlerësojmë gjendjen reale ekonomike në vend, angazhimin maksimal të të gjithë stafit kompetentë të MPMS-së edhe gjatë këtij viti, konstatojmë se janë realizuar parametrat e paraparë dhe janë arritur rezultate të kënaqshme.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2012 nga MPMS-ja janë hartuar edhe këto dokumente strategjike: Plani i veprimit të Partneritetit Evropian nga fushat e punës dhe të punësimit; Plani i standardeve minimale të shërbimeve publike të punësimit; Efektshmëria aktuale e Politikave Aktive të Tregut të Punës; Menaxhimi sipas performancës të Shërbimeve Publike të Punësimit; Menaxhimi i Cilësisë së Projekteve.

MPMS-ja gjatë 2012-ës, përmes qendrave regionale të punësimit (7) dhe zyrave komunale të punësimit (23) ka regjistruar 24.879 punëkërkues të rinj, janë çregjistruar 90.559 punëkërkues, janë evidentuar 9.434 vende të lira të punës, të gjetura përmes këshilltarëve të punësimit, ndërsa përmes procesit të ndërmjetësimit në punësim janë punësuar 7.692 punëkërkues.

MPMS-ja, sikundër viteve tjera, edhe gjatë vitit 2012, në bashkëpunim të ngushtë me UNDP-në, LUX-Development-in, Zyrën e BE-së në Prishtinë, Bankën Botërore, Aleancën Kosovare të Biznesit, MBPZhR-në, komunat dhe partnerët e tjerë, ka zhvilluar një sërë projektsh, ku në realizimin e këtyre projekteve janë angazhuar një numër i madh i punëkërkuesve. Vetëm në projektin “Punët Publike Kosova 2012”, projekt ky i financuar nga BB-ja dhe MPMS-ja, që ka vlerën prej 3.3 milion eurosh, në komunat e Kosovës, janë realizuar 45 projekte në të cilat për një periudhë disamujore, nga zyrat komunale të punësimit janë përfshirë 2.663 punëkërkues.

Gjithashtu në projektin e BE-së “Kosova e bukur” janë përfshirë, nga zyrat komunale të punësimit, 704 punëkërkues.



Në “Berza e punësimit 2012”, projekt ky që realizohet në bashkëpunim me AKB-në, janë përfshirë në procesin e trajnimeve dhe të punësimit 500 punëkërkues.

Numri i përgjithshëm i punëkërkesve të rinj të përfshirë në projektet e përbashkëta me partnerët e MPMS-së për vitin 2012 ka qenë 4.601 punëkërkes.

Me qëllim të gjetjes sa më të lehtë të vendeve të punës, MPMS-ja përmes shtatë qendrave rajonale të aftësimit profesional ka organizuar trajnime falas në rreth 35 profesione për punëkërkesit e regjistruar në shërbimet publike të punësimit. Për t'u ofruar kushte sa më të mira pune stafit dhe punëkërkesve që trajnohen, gjatë vitit 2012 janë ndërtuar dhe funksionalizuar dy objekte moderne për aftësim profesional, në Ferizaj dhe Gjilan.



Objekti i QAP në Gjilan



Objekti i QAP në Ferizaj

Gjithashtu një objekt i ngjashëm është në ndërtim e sipër edhe në Mitrovicë.

Trajnime profesionale në qendrat e aftësimit profesional kanë marrë 2 mijë e 605 punëkërkes, të cilët edhe janë certifikuar.

Përfitues përmes skemës së trajnimit në kompani, që është realizuar me mbështetjen e UNDP-së, janë 370, ndërsa nga LUX-Development-it janë 62. Në kuadër të projektit për punë publike janë përzgjedhur nëntë (9) projekte të kategorisë b, ku kandidatët krahas punës kanë zhvilluar edhe trajnimin profesional. Janë certifikuar nga QAP-i 204 kandidatë të përfshirë në këto projekte.

Përfitues përmes fondit të trajnimeve të menaxhuara nga MPMS-ja dhe të mbështetura nga projekti Lux-Development, janë 565 kandidatë.

Sipas profileve janë blerë shërbimet e trajnimit në: ECDL 240 kandidatë, Kontabilitet i Avancuar 270, Sërvisim i Ashensorëve 31 dhe Makineri të rëndë 24 kandidatë.

### **Mbikëqyrja e dispozitave ligjore që rregullojnë lëmin e punës, punësimit, sigurisë në punë dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve**

Për mbikëqyrjen e dispozitave ligjore, të aplikueshme tek ne, që rregullojnë aspekte të marrëdhënies së punës, sigurisë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientin e punës, inspektorët e punës kanë kryer rreth 7.100 inspektime të rregullta.

Masa e vërejtjes me shkrim është paraqitur ndaj 1.886 subjekteve punuese, ndërsa masa e gjobës ndaj 157 subjekteve. Janë kryer 62 inspektime të rasteve të aksidenteve në punë, ku 17 raste kanë rezultuar me fatalitet, kurse lëndime trupore në vendin e punës kanë pësuar 45 të punësuar.

Inspektorati i punës rezultate të kënaqshme ka shënuar edhe në luftimin e ekonomisë joformale ku janë legalizuar 3.430 punëtorë që kanë qenë duke punuar pa kontrata pune. Janë gjetur 460 subjekte që kanë zhvilluar veprimtari punuese ilegale/të paregjistruar, të cilat subjekte më pas edhe janë legalizuar.

Komitetet Lokale të Veprimit janë krijuar në të gjitha komunat dhe janë funksionalizuar. Janë hartuar, botuar dhe shpërndarë materialet informative për MPF-ja, si: fletëza informative për MPF-në dhe doracak për MPF-në.

### **Rritja e mirëqenies sociale përmes ofrimit të mbështetjes në komunitet dhe zvoglimi i varfërisë**

Konform përgjegjësisë që ka MPMS-ja në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, vëmendje e veçantë i është kushtuar qytetarëve me nevoja të veçanta, pa dallime etnike, fetare, gjinore e racore, nga fëmijët e deri tek të moshuarit pa përkujdesje familjare.

Është ofruar mbrojtje e fëmijëve në forma të ndryshme, si: kujdestaria, strehimi familjar, adoptimi, strehimi rezidencial e forma tjera të mbrojtjes.

Në fushën e antitrafikimit me qenie njerëzore, MPMS-ja është pjesë aktive kundër kësaj dukurie ku participon edhe me 50% të financimit të një strehimoreje që ofron përkujdesje dhe shërbime për mbrojtjen e këtyre viktimave.

MPMS-ja gjithashtu participon me 50% të mjeteve financiare për 6 shtëpi - strehimore regionale, që ofrojnë strehim dhe mbrojtje të viktimave të dhunës në familje.

Përkujdesje institucionale 24 orëshe kjo Ministri ka ofruar për fëmijët dhe të rriturit me retardime të lehta mendore për 130 rezidentë që ndodhen në Institutin Special në Shtime dhe në shtatë (7) shtëpi me bazë në komunitet.

Përkujdesje e njëjtë është treguar edhe ndaj 129 të moshuarve pa përkujdesje familjare në Shtëpinë për Persona të Moshuar në Prishtinë dhe në dy shtëpi me bazë në komunitet.

Në institucionet e lartcekura gjatë vitit 2012 ka pasur 24 vendosje të reja të kësaj kategorie.

Është realizuar plotësisht skema e ofrimit të mbështetjes financiare për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara deri në moshën 18 vjeçare për rreth 3 mijë familje, të cilat përfitojnë nga 100 euro në muaj për një fëmijë.

Strehimi familjar është ofruar për 575 fëmijë pa prindër, të cilët strehohen tek farefisi, ku familja strehuese merr nga 75 euro në muaj, kurse strehim familjar është ofruar edhe për 50 fëmijë të braktisur ku familja strehuese merr 150 euro në muaj.

Skema e Ndhmës Sociale (SNS) në janar ka startuar me 35.159 familje shfrytëzuese, kurse aktualisht në këtë skemë janë 31.111 familje. Shuma e përgjithshme për këtë skemë për vitin 2012 ka qenë rreth 28 milionë euro. Si rezultat i forcimit të kontrollit në Skemën e Ndhmës Sociale, është zvogëluar numri i familjeve shfrytëzuese të ndihmës sociale, ku nga kursimet financiare, është bërë pagesa e shtesave të fëmijëve për familjet e përzgjedhura në ndihmë sociale.

MPMS-ja ka ndarë edhe 44.450 euro si ndihma emergjente/ndihmë e njëhershme për 372 raste.

MPMS-ja, në bazë të marrëveshjes që ka me MZHE-në dhe KEK-un, ka ndarë edhe shumën prej 4.471.510 euro për pagesën e 258 KWh në muaj për shfrytëzuesit e SAS-it dhe familjet e kategorive të luftës.

Gjatë vitit 2012, Universiteti i Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), dhe MPMS-në, për vitin akademik 2011/2012, ka liruar nga shpenzimet e regjistrimit të semestrave, gjithsej 3.251 studentë, të cilët iu kanë takuar familjeve në SNS-ë, studentë invalidë të luftës, studentë të prindërve të vrarë në luftë, studentë me aftësi të kufizuara dhe studentë të familjeve që kanë pas 3 a më shumë studentë nga e njëjta familje.

*Numri i shfrytëzuesve të ndihmave sociale të proceduara për pagesë sipas muajve dhe shuma në euro për vitin 2012:*

<b>Pagesat e Ndhimave Sociale gjatë vitit 2012</b>				
<b>Muaji</b>	<b>Numri i familjeve</b>	<b>Numri i anëtarëve të familjes</b>	<b>Shtesa për fëmijët 0-18 vjeç</b>	<b>Shuma totale</b>
<b>Janar</b>	35,159	153,059		2,324,564.00 €
<b>Shkurt</b>	35,435	153,548		2,340,509.00 €
<b>Mars</b>	35,180	153,129		2,333,307.00 €
<b>Prill</b>	35,180	153,003		2,327,442.00 €
<b>Maj</b>	35,180	152,422		2,315,997.00 €
<b>Qershor</b>	33,773	145,928		2,215,937.00 €
<b>Korrik</b>	33,523	144,672		2,202,737.00 €
<b>Gusht</b>	33,054	142,420		2,165,845.00 €
<b>Shtator</b>	32,864	141,553		2,153,159.00 €
<b>Tetor</b>	29,919	126,943	319,846.66 €	1,949,807.00 €
<b>Nëntor</b>	30,697	130,440	319,846.67 €	2,024,847.00 €
<b>Dhjetor</b>	31,111	132,626	319,846.67 €	2,997,177.00 €
<b>Gjithsej:</b>			<b>959,540.00 €</b>	<b>27,351,328.00 €</b>

**Krijimi i një sistemi pensional treshtyllësh i drejt, funksional me burime të qëndrueshme financiare, i cili i plotëson kërkesat nga e drejta pensionale për të gjitha kategoritë e pensioneve**

Sipas planifikimit janë realizuar gjashtë skemat ekzistuese të pensioneve në Kosovë (Pensionet bazike, kontributeve, të aftësisë së kufizuar, të pensionistëve “Trepça”, atë të ish-pjesëtarëve të TMK-së dhe të FSK-së).

Në skemën e pensionit bazë, apo të pleqërisë, aktualisht janë 113.043 pensionistë. Shuma e paguar për këtë kategori ka qenë 69. 208. 570 euro.

Në skemën e pensioneve kontributpaguese janë 34. 722 pensionistë, kurse shuma për 2012 ka qenë 42.037.781 euro.

Numri i shfrytëzuesve të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara është 17. 531 persona. Shuma e paguar për këtë kategori për vitin 2012, ka qenë 11.558.210 euro.

Vlera e Pensioneve kontributpaguese nga 1 janari 2013 është ngritur në lartësi 40%, ndërsa pensionet bazë dhe pensionet e aftësisë së kufizuar nga 1 janari 2013 janë ngritur në vlerën 33,3%.

Në skemën e pensioneve të parakohshme “Trepça” aktualisht janë 3.913 shfrytëzues. Shuma e paguar për 2012 ka qenë 3.612.829 euro.

Numri i shfrytëzuesve të ish-pjesëtarëve të TMK-së është 728, kurse janë paguar 1.471.055 euro.

**Për 52 ish-pjesëtarë të FSK-së nga muaji tetor e deri në dhjetor 2012 janë paguar pensionet në vlerë prej 622. 647 euro.**

Për sigurimin pensional-invalidor me botën e jashtme gjatë vitit 2012, kanë aplikuar 1.016 aplikues, kurse shuma e mjeteve të realizuara për të gjithë shfrytëzuesit nga kjo kategori ka qenë 448.421 franga zvicerane dhe 43.704 euro.



Grupi punues për ripërtëritjen e marrëveshjeve sipas konventave ndërkombëtare të sigurimit pensional invalidor ka zhvilluar negociata të vazhdueshme me zyrtarët kompetentë të Austrisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi për arritjen e marrëveshjeve në këtë sferë. Negociatat u mbajtën në vazhdimësi të bisedimeve të datës 23-26 maj 2011, të mbajtura në Vjenë. Më datën 25 shtator 2012, në Podgoricë të Malit të Zi u mbajt takimi midis Delegacionit të Kosovës dhe të Malit të Zi. Temë e bisedimeve ishte këmbimi i informacioneve për sigurimin pensional dhe invalidor ndërmjet dy shteteve. Më datën 20.11.2012 dhe me 3 dhe 4 dhjetor 2012 në Shkup u mbajt takimi në mes të Delegacionit të Kosovës dhe Maqedonisë për harmonizimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për konfirmimin e periudhave të sigurimit për realizimin e së drejtës në pension.

### **Mbështetja e vazhdueshme përmes pagesave të pensioneve për kategoritë e luftës së UÇK-së**

Gjatë vitit 2012 të drejtën në pensione nga Skema e DFDIL-së e kane realizuar gjithsej 13.232 persona, për pagesën e këtyre pensioneve janë shpenzuar 30.609.890 euro

Për realizimin e aktiviteteve të Shoqatave të dala nga lufta, MPMS-ja ka ndarë 90.000 euro. Të drejtën në rehabilitim në banjat e Kosovës e kanë realizuar gjithsej 103 anëtarë të familjeve të dëshmorëve, 136 veteranë, 204 invalidë të UÇK-së dhe 50 ish të burgosur, ku gjithsej janë shpenzuar 93.480 euro. Janë financuar tri (3) projektet e shoqatave të dala nga Lufta, për çdo muaj nga 2,500 euro gjithsej për 12 muaj janë shpenzuar 90,000 euro.

Mjetet e dedikuara për investime kapitale janë orientuar në renovimin dhe mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese të MPMS-së, por edhe në ndërtimin e objekteve të reja si ndërtimi i ZKP-së në Deçan e Partesh, ndërtimi i QPS-ve në Kllokot dhe Han të Elezit, ndërtimi i objektit për banim social në Viti, fillimi i ndërtimit të QAP-it në Mitrovicë, ndërtimi i objektit të familjeve të dëshmorëve në Skenderaj. Gjithashtu është investuar edhe në projektin "Furnizimi me material ndërtimor sfidë për të gjithë".